

Kosova pritët
të ketë rreth
1.6 milion banorë



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

VAZHDON PROCESI GJYQËSOR NDAJ LIDERËVE TË UÇK-së
NË GJYKATËN SPECIALE NË HAGË

VESELI NË HAGË: MOS TË CENOHESET BESIMI I POPULLIT TË KOSOVËS NË GJYKATËN SPECIALE



Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka kërkuar nga trupi gjyqësor në Hagë, që procesi gjyqësor ndaj

tij, Thaçit, Selimit dhe Krasniqit të jetë i drejtë, transparent dhe në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Po

ashtu, ai ka kërkuar nga trupi gjyqësor të mos cenohet besimi i popullit të Kosovës në Gjykatën Speciale

KOSOVA MERR STATUSIN E ANËTARES SË ASOCIUAR NË ASAMBLENË PARLAMENTARE TË NATO-së

Asambleja Parlamentare e NATO-s e ka miratuar të hënën rekomandimin për avancim të statusit të Kosovës nga anëtare vëzhguese në anëtare të asociuar. Shumica e vendeve kanë votuar për, një votë ka qenë kundër dhe 14 vende të tjera kanë abstenuar në takimin e Asamblesë që po mbahet në Sofje të Bullgarisë



AMBASADORI I BE-SË: KOSOVA TA HEQË NDALIMIN E MALLRAVE SERBE SA MË SHPEJT



AKTUALE



QEVERIA E RE MAQEDONASE DREJT
FORMIMIT, KRYETARI I KUVENDIT
PRITET TË JETË SHQIPTAR

KDI-JA DHE KOMUNA E GJAKOVËS
NËNSHKRUAJNË PAKTIN E PARË TË
INTEGRITETIT NË KOSOVË

DIALOGU DHE ZGJERIMI,
PRE E SË DJATHTËS NË BE

EKONOMI



DHOMA E TREGTISË KËRKON NGA
QEVERIA T'I DËGJOJË MË SHUMË
KËRKESAT E BIZNESEVE

IFC-JA EMËRON INES ROCHA
DREJTORESHË TË RE RAJONALE
PËR EVROPËN

SPORT



LLAPI 'BLINDON' JANUZIN,
MUSOLLIN DHE AVDYLIN

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
030-500 878 | 045-500 878
044-500 878 | 049-500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Qeveria e re maqedonase drejt formimit, kryetari i Kuvendit pritët të jetë shqiptar

SHKUP, 27 MAJ - VMRO DPMNE-ja dhe koalicioni i katër partive politike shqiptare, VLEN, thonë se kanë përfunduar bisedimet për bashkëqeverisje dhe për ndarjen e posteve ministrore në Qeverinë e re të Maqedonisë së Veriut, por marrëveshja nuk do të publikohet pa mbylljen e bisedimeve edhe me lëvizjen ZNAM, një parti që pritët të jetë pjesë e ekzekutivit të ardhshëm. Bazuar në prononcimet e zyrtarëve të VMRO DPMNE-së, marrëveshja do të bëhet e ditur pas konstituimit të Kuvendit të ri, më 28 maj. Pas mbledhjes së Kuvendit, kryetari i VMRO-së, Hristijan Mickovski, në afat prej 10-ditësh duhet ta marrë mandatin për formimin e qeverisë së re nga presidentja e shtetit Gordana Silanovska-Davkova. "Bisedimet janë në një fazë të avancuar, por ende nuk kemi marrëveshje finale dhe derisa nuk e kemi një gjë të tillë, nuk do të mund të japim detaje. Bisedimet po zhvillohen për të

gjitha çështjet, ndarjen e resorëve, mbi të gjitha, për kuadrot që duhet të jenë të pranueshëm dhe të gatshëm të punojnë mbi parimet bazë të punës së qeverisë së re", ka deklaruar zëdhënësi i VMRO DPMNE-së, Naum Stoilkovski. Detaje nuk kanë dhënë as partitë politike shqiptare duke ia lënë këtë kryetarit të VMRO DPMNE-së, Hristijan Mickovski. Jozyrtarisht bëhet me dije se partitë shqiptare që tani janë në opozitë, në qeverinë e re do të drejtojnë gjashtë ministri: shëndetësinë, ekonominë, ambientin jetësor, sistemin politik, punën dhe politikën sociale, një ministër parësor, si dhe një zëvendëskryeministër. Pjesë e bisedimeve është edhe Sekretariati për Çështje Evropiane. Partitë shqiptare në qeverinë e re, siç bëhet me dije, do të kenë edhe gjashtë zëvendësministra: në Ministrinë e Arsimit, atë të Punëve të Brendshme dhe të



Mbrojtjes.

Arben Taravari nga koalicioni VLEN nuk i ka hedhur poshtë këto të dhëna që tashmë përmenden në media dhe në opinionin e gjerë. "Mund të them se 95 për qind e zgjidhjeve kadrovike, për të cilat kemi rënë dakord tanimë, janë rrotulluar (raportuar) nëpër medie. Besoj

se këtyre ditë do të bëhen publike pasi ajo [VMRO DPMNE-ja] synon të ketë mbi 80 vota në shumicën e re qeveritare, kështu që fjala përfundimtare është te mandatar i ardhshëm", ka thënë Taravari.

Në rast se bisedimet mbyllen me sukses, këto tri subjekte politike do të kenë një shumicë

parlamentare prej 78 deputetësh, por VMRO DPMNE-ja synon numrin prej 83 deputetëve apo dy të tretat për t'i miratuar ligjet që kërkojnë këtë shumicë të votave.

Partitë shqiptare, bazuar në prononcimet e tyre, do të udhëheqin Kuvendin e Maqedonisë së Veriut që pritët të konstituohet të martën, më 28 maj.

Në këtë pozitë pritët të emërohet Afrim Gashi nga parti Alternativa, që është pjesë e koalicionit VLEN. Gashi në një prononcim për medie nuk e ka përgënjeshtuar lajmin duke thënë se "me rëndësi është që shqiptarët do të vazhdojnë të kryejnë një nga tri funksionet më të rëndësishme në shtet", që nënkupton se kryetar i Kuvendit do të zgjidhet një shqiptar.

Bazuar në paralajmërimet e VMRO DPMNE-së, Qeveria e re e Maqedonisë së Veriut pritët të zgjidhet më së voni deri më 20 qershor.

Rritet numri i aplikimeve për natyralizim prej izraelitëve me rrënjë gjermane



BERLIN, 27 MAJ - Është rritur numri i izraelitëve me prejardhje gjermane që janë duke aplikuar për natyralizim, ka thënë grupi medial RND të hënën, duke cituar Zyrrën Federale të Administratës së Gjermanisë. Sipas raportit, 6 869 aplikime janë pranuar në periudhën janar-prill të këtij viti, në krahasim me 9 129 më 2023 dhe 5 670 më 2022.

Prej gushtit të vitit 2021, të gjithë ata që janë persekutuar prej regjimit nazist, për shkak të besimeve të tyre politike, racore dhe fetare, si dhe pasardhësit e

tyre, kanë të drejtë ligjore për t'u pajisur me pasaportë gjermane. Pasardhësit e viktimave të nazistëve që kanë ikur prej Gjermanisë kanë, po ashtu, të drejtë që të marrin pasaportë gjermane, pa asnjë kusht.

Prej nisjes së sulmeve të grupit palestinez Hamas - të shpallur terrorist prej Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian - më 7 tetor të vitit të kaluar, në jug të Izraelit, është vërejtur rritje e interesimit për aplikime të tilla.

Në atë sulm militantët e Hamasit kanë vrarë rreth 1 200 njerëz,

kryesisht civilë, dhe kanë marrë pengë 250 të tjerë.

Hamasi ende i mban peng rreth 100 persona.

Sipas autoriteteve shëndetësore të Gazës, si pasojë e ofensivës izraelite, të nisur më pas, janë vrarë rreth 36 000 palestinezë.

Izraeli e fajëson Hamasin, me arsyetimin se po operon në zona të banueshme.

Autoritetet gjermane kanë bërë me dije se më 2023 janë dorëzuar 14 000 kërkesa për natyralizim. Pas Izraelit, kërkesat më të mëdha janë prej shtetasve amerikanë.

Parlamenti i Gjeorgjisë, një hap më afër rrëzimit të vetos ndaj ligjit për "agjentë të huaj"

TBILISI, 27 MAJ - Një komitet parlamentar në Gjeorgji e ka hedhur poshtë veton e presidentes pro-perëndimore të shtetit, Salome Zurbishvilit, për të ashtuquajturin ligj për "agjentë të huaj", duke ua mundësuar deputetëve ta zbatojnë legjislacionin, pavarësisht protestave të brendshme dhe kritikave të Perëndimit që një vendim i tillë po dëmton rrugën e Gjeorgjisë drejt komunitetit euroatlantik. Ligji do t'u kërkonte medieve dhe organizatave joqeveritare që të regjistroheshin si "përmbushës të interesave të një fuqie të huaj",

nëse marrin më shumë se 20 për qind të fondeve prej jashtë. Duke marrë parasysh vendimin e Komitetit Parlamentar për Çështje Ligjore, ligjvënësit e Gjeorgjisë pritët ta shqyrtojnë përmbysjen e vetos së presidentes në një seancë të mbajtur më 28 maj. Partia në pushtet, Ëndrra Gjeorgjiane, e cila e ka shtyrë përpara miratimin e legjislacionit, e gëzon shumicën në Parlament dhe pritët ta rrëzojë lehtësisht veton.

Komiteti parlamentar e ka marrë vendimin pavarësisht një

proteste paqësore të mbajtur në Tbilisi më 26 maj dhe një paralajmërimi të Avokatit të Popullit në Gjeorgji, Levan Ioseliani, që ligji, të cilit zërat kritikë i referohen edhe si "ligji rus" - për shkak të ngjashmërisë që ka me ligjin që përdor Rusia për t'i heshtur zërat kundërshtarë - duhet të ndryshohet për ta zvogëluar dëmin në shoqërinë civile.

Mijëra persona, kryesisht të rinj, kanë marshuar në Tbilisi në Ditën e Shtetësisë, më 26 maj, duke bërë thirrje që Ëndrra Gjeorgjiane të heqë dorë prej ligjit.



VAZHDON PROCESI GJYQËSOR NDAJ LIDERËVE TË UÇK-së NË GJYKATËN SPECIALE NË HAGË

Veseli në Hagë: Mos të cenohet besimi i popullit të Kosovës në Gjykatën Speciale

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka kërkuar nga trupi gjykues në Hagë, që procesi gjyqësor ndaj tij, Thaçit, Selimit dhe Krasniqit, të jetë i drejtë, transparent dhe në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Po ashtu, ai ka kërkuar nga trupi gjykues të mos cenohet besimi i popullit të Kosovës në Gjykatën Speciale

EPOKA
ERE

Lirim GECI

HAGË, 27 MAJ - Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka folur të hënën në seancën gjyqësore në Hagë. Duke u ndërlidhur me deklaratat në këtë seancë, Veseli ka kërkuar që procesi të jetë i drejtë, transparent dhe në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. “Do të jem i shkurtër dhe i drejtpërdrejtë me ju për faktin se është në interesin publik. Çështja e parë ka të bëjë me kohëzgjatjen e këtij procesi, që nga dita e parë kur jemi futur në këtë sallë, prokuroria ka kërkuar në mënyrë transparente 545 orë. Prej ditës së parë, faktikisht, secili e kemi ditur se 545 orë me procesin që do ta zhvillojmë në këtë sallë, do të kalonin 3 vjet ose 4 vjet, edhe nëse fare asnjë pyetje nuk do të bënte as mbrojtja e as ju si trup gjykues. Nuk dua të paragjykoj, por dua të them se: besoj është në interes të publikut, jo vetëm tonin, që dikush duhet të marrë përgjegjësinë e vendimmarrjes, që ky proces para popullit të Kosovës të jetë jo vetëm fer, jo

vetëm transparent, jo vetëm t'i respektojë procedurat e Kushtetutën e Kosovës, por edhe të ruajë dhe garantojë një gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme”, ka thënë Veseli. Më tutje, Veseli ka kërkuar të mos cenohet besimi i qytetarëve të Kosovës në drejtësinë ndërkombëtare. “Unë si një nga të akuzuarit, i nderuar, frikësohem se nëse nuk respektohen këto parime. Nuk ka të bëjë me fatin tonë individual, por me një mesazh që do ta dërgojmë te populli i Kosovës, i cili e ka krijuar, me vetëdije të plotë, por edhe me besim këtë gjykatë, tek ju si partnerë tanë ndërkombëtarë, dhe nuk duhet në asnjë mënyrë të cenohet besimi që ka shteti ligjor dhe drejtësia ndërkombëtare”, ka thënë Veseli. Veseli ka komentuar edhe përplasjet e ashpra që janë shfaqur ndërmjet kryetarit të trupit gjykues, Charles Smith dhe avokatit të tij, Ben Emmerson. “Është edhe një çështje tjetër që ka të bëjë me mua si të akuzuar dhe me avokatin tim: i nderuar trup gjykues, po e shoh një



komunikim që nuk është normal e joprofesional. Nuk po paragjykoj, por si i akuzuar kam të drejtë të jap mesazh: nuk do të doja që në gjera që janë jashtë realitetit tim të ndikohet e paragjykohet, sepse ka një mospërmbajtje në adresimet e avokatit tim”, ka thënë Kadri Veseli.

Një përplasje “brutale” ka ndodhur në këtë seancë në rastin e krerëve të UÇK-së në Hagë. Avokati i Kadri Veselit është “kapur” me kryegjyqtarin Smith lidhur me faktin se gjykimi po stërzgjetet. Ben Emmerson ka kërkuar të shkurtrohet koha, pasi kanë mbetur edhe 101 dëshmitarë për t'u ftuar.

Emmersoni ka deklaruar se më shumë pyetje për dëshmitarë kanë bërë gjyqtarët se mbrojtja e Veselit. “Ta bëjë realizimin e t'i paraqes provat në mënyrë efikase dhe mbrojtja po bën të

pamundurën. Ne këto konstatime i marrim vetëm gjatë pyetjeve. Është e pamundur të pritët që ekipet e mbrojtjes ta reduktojnë kohën për kundërpjetet në bazë të asaj që thotë ekipi tjetër i mbrojtjes. Kjo është e padrejtë. Është e padrejtë të fajsohemi ne për mungesën e efikasitetit të tyre. Çështja është kjo: pavarësisht shkurtimit të vogël që ka bërë prokuroria, kanë mbetur 101 dëshmitarë për të thirrur. Deri tani për 1 vit kemi bërë vetëm 66 dëshmitarë. Ky është qëndrimi ynë”, ka thënë Emmersoni, duke vazhduar me kritika ndaj trupit gjykues. “Dhe ne e kemi kuptuar kështu që ju ia kishit bërë të qartë prokurorisë sepse vetëm 2 vjet kishin në dispozicion, dhe tani i vihet përgjegjësia mbrojtjes, dhe jemi në situatë ku ky parashikim nuk do të respektohet kurrsesi. Qoftë për faj të mbrojtjes, apo prokurorisë, apo të dyja palëve.

Fakti është që mbrojtja e Veselit ka kërkuar vetëm 43 orë e 33 minuta për kundërpjetet. Trupi gjykues ka përdorur 44 orë e 36 minuta. Siç tha Misetiq, është përgjegjësia e të gjitha palëve që ky gjykim të kryhet brenda një afati të arsyeshëm. Trupi gjykues e di shumë mirë sa kohë i nevojitet paraprakisht”, ka thënë Emmersoni.

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS), e cila ishte zotuar se do të përfundonte me dëshmitarët e saj, deri në prill të vitit 2025 në rastin Thaçi dhe të tjerët, por kur është pyetur të hënën nga gjyqtari në lidhje me këtë afat, nga kjo zyrë kanë thënë se s'mund të garantojnë një gjë të tillë.

Nga ZPS-ja kanë thënë se hapa pozitivë ka, por garanci jo. “Do të referohem asaj në shkurt, që ne nuk po garantonim që do ta mbyllim çështjen tonë, por nuk thamë as që nuk do ta bënim. Kemi thënë se presim edhe zvogëlime të tjera për t'iu përmbajtur afatit kohor. Mund të them se kemi hapa pozitivë, përmirësime, nuk mund të garantoj që do t'i përmbahemi këtij afati, por duke marrë parasysh ritmin e përshpejtuar, por ky afat kohor mbetet i arritshëm”, kanë thënë nga ZPS-ja. Procesi gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimit, ka filluar në prill të vitit 2023, ndërsa ata janë duke u mbajtur në paraburgim nga nëntori i vitit 2020.

Kosova pritet të ketë rreth 1.6 milion banorë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 MAJ - Rreth 1.6 milion banorë të Kosovës besohet se kanë marrë pjesë në procesin e regjistrimit të popullsisë, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Në procesin e mëparshëm të regjistrimit të popullsisë, të mbajtur në vitin 2011, patën marrë pjesë rreth 1.74 milion banorë.

Kjo do të thotë se popullsia në Kosovë besohet të ketë rënë për rreth tetë për qind. “Ne e dimë të gjithë që ka tkurrje [të popullsisë], por ka edhe ndryshim edhe brenda Kosovës. Disa qytete janë rritur në mënyrë enorme, ndërsa disa janë zvogëluar”, ka thënë kryeshefi ekzekutiv i ASK-së, Avni Kastrati, në konferencën e mbajtur më 27 maj.

Për dallim nga regjistrimi paraprak, këtë vit diaspora e Kosovës e ka pasur mundësinë të regjistrohej online përmes portalit eKosova.



Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) ka bërë me dije se ky proces tani është zgjatur deri në fund të gushtit. Sipas të dhënave të ASK-së, deri më tani besohet do të jenë rreth 600 mijë pjesëtarë të diasporës të cilët nuk janë përfshirë në shifrën prej 1.6 milion banorëve që besohet se jetojnë në Kosovë.

Qeveria e Kosovës e ka zgjatur procesin e regjistrimit sivjet që ka nisur më 5 prill dhe duhej të përfundonte më 17 maj, për shtatë ditë, pas kërkesave nga

disa komuna për zgjatje të afatit.

Kastrati është shprehur i kënaqur me procesin e regjistrimit dhe ka thënë se janë plotësuar të gjitha parimet ndërkombëtare për procese të tilla. “Në përgjithësi të gjitha komunitetet në Kosovë kanë qenë të hapura dhe kanë qenë në favor të regjistrimit të popullsisë. Pjesëmarrja e të gjitha komuniteteve ka qenë masive, përveç komunitetit serb në katër komunat në veri, që kanë marrë pjesë pjesërisht”,

ka thënë ai.

Kastrati ka thënë, po ashtu, se janë mbajtur tri herë trajnime për regjistruet nga komuniteti serb, meqë disa kanë dhënë dorëheqje, pas nisjes së procesit. Ai ka thënë se për pasojë, disa shërbime institucionale nuk do të mund t'u ofrohen qytetarëve që nuk kanë qenë pjesë e procesit të regjistrimit të popullsisë.

Më 5 prill, kur edhe pati filluar regjistrimi, Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë e cila gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar, ka thënë se serbët nuk do të merrnin pjesë në procesin e regjistrimit të popullsisë.

Një bojkot i ngjashëm ka ndodhur edhe në regjistrimin paraprak të popullsisë në vitin 2011. Ai proces nuk është mbajtur në katër komunat në veri – Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan – të banuara me shumicë serbe, ndërsa edhe serbët në komunat e tjera në jug, me ftesë të Beogradit,

kryesisht e patën bojkotuar procesin.

Sipas Ligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, çdo person mund të gjobitet nga 30 deri në 2 000 euro nëse refuzon t'i japë informacionet e kërkuara nga regjistruesi. Gjobat janë edhe më të mëdha, deri në 20 000 euro, për biznese.

Kastrati ka thënë se tani do të punohet në përpunimin, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave. Sipas tij, të dhënat preliminare mund të publikohen dikur gjatë pjesës së parë të muajit korrik, ndërsa të dhënat finale pritet të publikohen rreth gjashtë muaj pas datës së nisjes së regjistrimit.

Kastrati ka thënë se gjatë procesit janë kursyer rreth 2.5 milionë euro për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të regjistrimit, blerjen e pajisjeve dhe për pagat e regjistruesve. Sipas tij, regjistrimi i ardhshëm do të mbahet në vitin 2031.



Kosova merr statusin e anëtares së asociuar në Asamblenë Parlamentare të NATO-s

Asambleja Parlamentare e NATO-s e ka miratuar të hënën rekomandimin për avancim të statusit të Kosovës nga anëtare vëzhguese në anëtare të asociuar. Shumica e vendeve kanë votuar për, një votë ka qenë kundër dhe 14 vende të tjera kanë abstenuar në takimin e Asamblesë që po mbahet në Sofje të Bullgarisë

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 27 MAJ - Asambleja Parlamentare e NATO-s e ka miratuar të hënën rekomandimin për avancim të statusit të Kosovës nga anëtare vëzhguese në anëtare të asociuar. Shumica e vendeve kanë votuar për, një votë ka qenë kundër dhe 14 vende të tjera kanë abstenuar në takimin e Asamblesë që po mbahet në Sofje të Bullgarisë

Avancimi i statusit vjen pas disa viteve të bashkëpunimit të shkëlqyeshëm mes Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Asamblesë Parlamentare të

NATO-s.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka falënderuar vendet anëtare që e kanë miratuar avancimin e pozitës së Kosovës dhe ka thënë se e ardhmja e vendit që udhëheq ajo është në NATO. “Ky vendim do të garantojë se do të dëgjohet zëri i popullit më pro-NATO-s në gjithë botën. Ne do t'i vazhdojmë përpjekjet tona, bashkë me aleatët, që të avancojmë në rrugën tonë drejt anëtarësimit në NATO”, ka shkruar Osmani në “X”.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, e ka quajtur të shkëlqyer vendimin e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, që Kuvendit të Republikës së

Kosovës t'i jepet statusi i anëtarit të asociuar në AP të NATO-s. “Urime të gjithë qytetarëve tanë dhe mirënjohje të gjithë anëtarëve të AP të NATO-s, që me votën e tyre e jetësuan këtë arritje shumë të rëndësishme! Një falënderim i veçantë shkon edhe për Delegacionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës në AP të NATO-s! Përpjekja dhe angazhimi maksimal i këtij delegacioni u finalizua me këtë sukses të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe shtetit tonë në tërësi. Republika e Kosovës është një histori sukcesi e NATO-s, e interesave dhe qëllimeve të tij, ndërsa NATO është destin i Kosovës. Hapat në këtë frymë na gëzojnë dhe na e shtojnë më tej përgjegjësinë dhe përkushtimin në drejtim të paqes dhe stabilitetit, vlerave dhe synimeve të përbashkëta”, ka shkruar Konjufca në “Facebook”.

Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se me shumicë të votave të delegatëve nga vendet anëtare të NATO-s, Kuvendi i Republikës sonë tash ka statusin e anëtarit të asociuar në Asamblenë Parlamentare të

NATO-s. “Në prag të 25-vjetorit të çlirimit, Sofja, kryeqyteti i shtetit që 25 vjet më parë hapi hapësirën e vet ajrore për aeroplanët e NATO-s në fushatën kundër Serbisë, sot ishte vendtakimi në të cilin bëmë një hap të rëndësishëm në integrimin euro-atlantik, përkundër fushatës së Serbisë. Përgëzime të gjithë zyrtarëve të shtetit që punuan për këtë arritje, e shumë urime qytetarëve të Republikës. Falënderim dhe mirënjohje për të gjithë miqtë e partnerët që me votën e tyre sot i dhanë mbështetje avancimit të statusit të Kosovës në Asamblenë e Parlamentare të NATO-s dhe që i qëndrojnë përkrah Kosovës përherë”, ka shkruar Kurti në “Facebook”.

Edhe kandidati për kryeministër, Bedri Hamza, ka thënë se është një lajm i mirë që Asambleja Parlamentare e NATO-s miratoi rekomandimin për avancim të statusit të Kosovës nga anëtare vëzhguese në anëtare të asociuar. “Ne tani duhet t'i rrisim përpjekjet që t'i bashkohemi strukturave të aleancës veriatlantike, duke nisur nga

Partneriteti për Paqe. Nga një konsumuese e sigurisë, Kosova duhet të bëhet kontribuese në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Duhet ta rrisim stabilitetin dhe të ndërtojmë raporte më të forta të sigurisë me të gjitha shtetet partnere dhe NATO-n. I jam mirënjohës shteteve aleate dhe të gjitha organizatave ndërkombëtare që e kanë përkrahur dhe po vazhdojnë ta përkrahin Kosovën në rrugën e saj të integritetit në Bashkimin Evropian dhe në familjen e Kombeve të Bashkuara. Na duhet më shumë punë, më shumë progres dhe më shumë paqe e stabilitet në gjithë rajonin tonë. E ardhmja e Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor nuk është në konflikte, por në integritet euroatlantike!”, ka shkruar Hamza në “Facebook”.

Shefi i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, ka thënë se avancimi i pozitës së Kosovës i ka ekspozuar të gjitha politikat e dyfishta të Perëndimit, duke pretenduar se “as garancitë e BE-së dhe as NATO-s nuk vlejnë kur bëhet

fjalë për serbët”. “Jemi dëshmitarë se sa shumë, sidomos kohët e fundit, po ushtrojnë presion të fortë ndaj Serbisë dhe popullit serb, sepse është e qartë se një Serbi e fortë e udhëhequr nga Aleksandar Vuçiqi është gjemb në këmbë për fuqitë e shumta perëndimore”, ka thënë Petković përmes një deklarate.

Për këtë vendim ka reaguar në “Facebook” edhe eksperti i sigurisë, Burim Ramadani, duke theksuar se Asambleja Parlamentare e NATO-s është institucion i pavarur nga NATO dhe shërben si urë lidhëse për ta avancuar të kuptuarit e

politikave të NATO-s në shtete veç e veç. Sipas tij, avancimi në status të asociuar për Kosovën aty është shenjë e mirë e mbështetjes euroatlantike, por krejtësisht simbolik. “Rruga e Kosovës drejt NATO-s duhet të jetë synimi kryesor i Kosovës. Kjo nuk ka të bëjë me Asamblenë Parlamentare të NATO-s, por me domosdoshmërinë për dialogun politik NATO - Kosovë, aranzhmane të reja operacionale NATO - Kosovë, ftesë në planin e veprimit për anëtarësim, pranim të përfaqësishëm diplomatike të Kosovës në NATO, partneritet për paqe”, ka shkruar Ramadani.

Çfarë është Asambleja Parlamentare e NATO-s?

Asambleja Parlamentare e NATO-s është institucionalisht e ndarë nga NATO-ja, por shërben si një lidhje e rëndësishme në mes të NATO-s dhe parlamenteve të vendeve anëtare. Ajo përbëhet nga 281 delegatë nga të 32 vendet anëtare të NATO-s. Përveç tyre, në aktivitete të saj marrin pjesë edhe delegatë nga nëntë vende të asociuara, katër vende të asociuara mesdhetare, si dhe tetë

delegacione vëzhguese parlamentare. Anëtarët e asociuar mund të paraqesin rezoluta dhe ndryshime në rezoluta. Gjithashtu, mund të shërbejnë si raportues specialë të asociuar në komitete, për t'i paraqitur perspektivat e tyre në raportet NATO-Asamble Parlamentare. Megjithatë, ata nuk kanë të drejtë të votojnë për raportet, rezolutat

apo udhëheqjen e Asamblesë dhe as nuk kontribuojnë në buxhetin e saj. Aktualisht anëtare të asociuara janë nëntë - në mesin e tyre edhe Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina. Kuvendi i Kosovës prej vitesh është delegacion vëzhgues me dy ulëse. Tani, me avancimin e statusit, do të mund të zgjerohet edhe delegacioni pjesëmarrës i Kosovës.

Dialogu dhe zgjerimi, pre e së djathtës në BE

PRISHTINË, 27 MAJ - Nëse sondazhet dalin të sakta, zgjedhjet për Parlamentin e ri Evropian do të tregojnë rritje të mbështetjes për partitë populiste të krahut të djathtë dhe për ato të ekstremit të djathtë - tashmë pjesë e disa parlamenteve kombëtare. Këto forca mbështesin një mendim politik që ka tendencë të jetë më konservator dhe më nacionalist. Janë kundër imigrimit, kundër multikulturalizmit e disa edhe kundër zgjerimit të BE-së.

Me fjalët e kancelarit gjerman Olaf Scholz, “populistët e krahut të djathtë janë gati të shkatërrojnë atë që kemi ndërtuar për fëmijët tanë; ata ngjallin ndjenja kundër refugjatëve dhe pakicave”. Zgjedhjet për Parlamentin Evropian do të mbahen nga data 6 deri më 9 qershor. Deputetët e këtij institucioni zgjidhen drejtpërdrejt nga qytetarët - mbi 400 milionë syresh në të 27 vendet anëtare.

Një sondazh i kryer nga Këshilli Evropian për Marrëdhënie me Jashtë ka gjetur se ky proces do të sjellë forcim të ndjeshëm të së djathtës radikale.

Arsyet variojnë - nga rritja e vazhdueshme e kostos së jetesës deri te frika se kufijtë e hapur rrezikojnë identitetin kombëtar dhe vlerat tradicionale.

Për pasojë, dy grupet kryesore politike - Partia Popullore Evropiane dhe Aleanca Progresive e Socialistëve dhe Demokratëve - do ta ruajnë shumicën, por me rezultate më të dobëta, sipas sondazhit. Ato kanë përjetuar rënie edhe në zgjedhjet e vitit 2019 tashmë - grupi i parë për 2.8 për qind, ndërsa i dyti për 5.9 për qind.

Në përbërjen në largim të Parlamentit Evropian, e djathta ka 128 vende nga 705 gjithsej. Në përbërjen e ardhshme, sipas sondazheve, ajo mund të fitojë pothuajse një të katërtën e tyre. Vesko Garçeviq, i cili ka shërbyer ambasador i Malit të Zi në Bruksel, shpjegon për programin Expose të Radios Evropa e Lirë se



Parlamenti Evropian ka më pak ndikim se dy institucionet e tjera të BE-së - Komisioni Evropian dhe Këshilli Evropian - por shton se ai nuk mund të anashkalohet për disa çështje të rëndësishme. Për shembull, Komisioni Evropian nuk mund ta marrë detyrën pa u konfirmuar me shumicë votash në Parlamentin Evropian. “Trendi i rritjes së partive të djathta do të reflektohet në përbërjen e Parlamentit të ri Evropian. Por, çështja është nëse ato parti do të jenë vendimmarrëse, kur bëhet fjalë për komisionin e ri, apo do të jenë pakicë e konsiderueshme brenda parlamentit. Kjo është shumë e rëndësishme dhe jam i sigurt se do ta përcaktojë mënyrën se si parlamenti dhe institucionet e tjera evropiane do të punojnë në vitet në vazhdim”, thotë Garçeviq. Sondazhi i Këshillit Evropian për Marrëdhënie me Jashtë ka gjetur se partitë e së djathtës radikale kanë tendencë të dalin të parat në nëntë vende të Evropës, përfshirë: Francën, Austrinë dhe Italinë, ndërsa të dytat ose të tretat në nëntë vende të tjera, përfshirë Gjermaninë dhe Spanjën. Garçeviq thotë se kjo është problematike, sepse ndikimi që kanë këto zgjedhje në debatet kombëtare, implikon edhe vendimet e Komisionit dhe të Këshillit Evropian. Garçeviq përmend në mënyrë të veçantë Ballkanin Perëndimor. “Këtu jam i shqetësuar sidomos për zgjedhjet në Francë. Ato mund ta ndryshojnë lojën, sepse janë shtetet individuale ato që e formësojnë qasjen e Bashkimit Evropian kur bëhet fjalë për

Ballkanin”, thotë ai. Këtij qëndrimi i bën jehonë edhe Andi Hoxhaj, ligjërues në Kolegjin Universitar të Londrës. Duke folur për Exposenë, ai pret që partitë e ekstremit të djathtë ta zgjasin mbylljen e BE-së ndaj rajonit të Evropës juglindore. “Shumë prej tyre janë kundër zgjerimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor për shkak të, siç thonë, çështjeve kulturore dhe problematikave institucionale. Nëse partitë e ekstremit të djathtë do të kenë fuqi më të madhe seç kanë aktualisht, atëherë politika e zgjerimit do të jetë në pikëpyetje goxha të madhe”, thotë Hoxhaj. Hoxhaj thotë se kjo politikë do ta lërë edhe një rrezik pas - atë të influencës edhe më të madhe nga Rusia dhe Kina. Si vende më të cenueshme, ai përmend Serbinë dhe Bosnjë-Hercegovinën. Dhe për këtë bën përgjegjëse vetë BE-në. “... sepse BE-ja ka lënë një vakum në Ballkanin Perëndimor, duke qenë se politika e zgjerimit, në 15 vitet e fundit, është përdorur vetëm për influencë në Ballkan, por pa pasur një qasje afatgjatë se kur këto vende do të integrohen, apo si do të integrohen. Ky vakum pastaj ka bërë që fuqitë e mëdha, si Kina dhe Rusia, të ndërhyjnë me investime të jashtëzakonshme në infrastruktura specifike, si: ekonomia, transporti e kështu me radhë”, thotë Hoxhaj. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, e cila këtë vit do të kandidojë për rizgjedhje, ka thënë në fjalimin për gjendjen e BE-së në shtatorin e kaluar, se blloku duhet t'i përgjigjet “thirrjes së historisë”

dhe të pranojë një numër të madh vendesh, përfshirë nga Ballkani Perëndimor. “E ardhmja e Ballkanit Perëndimor është në Unionin tonë”, ka thënë ajo. BE-ja ka shprehur mbështetje për perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor qysh në vitin 2003, në një samit në Selanik të Greqisë. Por, që nga ajo kohë vetëm Kroacia nga vendet e këtij rajoni është anëtarësuar në BE në vitin 2013. Të tjerat janë në faza të ndryshme të integritimit, ndërsa Kosova është më së largu - ajo vetëm ka aplikuar për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2022.

Me rritjen e së djathtës ekstreme, Garçeviq, tani profesor i Praktikës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e Bostonit, thotë se Kosovës do t'i vështirësohet tutje edhe procesi i normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë. “Për shkak të ideologjisë dhe jo interesave në rajon, partitë e ekstremit të djathtë do të dalin në anën e Serbisë dhe do ta mbështesin atë kundrejt Kosovës. Kjo, pastaj, do ta zgjasë edhe më shumë procesin e negociatave mes tyre. E nëse ndryshon edhe administrata amerikane, ajo mund të anojë më shumë kah Serbia. Në një skenar të tillë, mund të imagjinojë edhe rikthimin e idesë për shkëmbimin e territoreve në mes të Kosovës dhe Serbisë në vitet e ardhshme”, thotë Garçeviq. Në zgjedhje, pas atyre për Parlamentin Evropian, do të jetë edhe shefi i politikës së jashtme të BE-së - përgjegjës edhe për ndërmjetësimin e dialogut Kosovë - Serbi. Në pesë vjetët e

kaluar këtë pozitë e ka mbajtur Josep Borrell, diplomat nga Spanja - vend që nuk e njeh pavarësinë e Kosovës.

Analistët tërheqin vërejtjen se disa udhëheqës nacionalistë në Ballkan mund të përpiqen edhe ta shfrytëzojnë vakumin politik, që rezultojnë nga këto procese zgjedhore, për ta komplikuar situatën në terren. Në mënyrë të veçantë përmenden presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, dhe presidenti i Republikës Sërpska në Bosnjë-Hercegovinë, Millorad Dodik, që të dy me pikëpamje shpesh pro-ruse.

Shqetësim në vete, sipas tyre, përbën edhe Maqedonia e Veriut, ku këtë muaj partia nacionaliste VMRO-DPMNE është kthyer në pushtet, duke i fituar zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale. “Së pari Ballkani, pastaj Brukseli”, ka thënë presidentja e re e këtij vendi, Gordana Silanovska-Davkova.

Analistët nuk presin që nga rritja e së djathtës të ketë ndonjë ndryshim politik sa i përket Ruisë dhe Ukrainës - dy vendeve në luftë - apo mbrojtjes së lirisë në Evropë.

Për t'ia ndalur hovin kësaj rryme, ata thonë se, mes të tjerash, duhen përmirësuar kushtet sociale dhe ekonomike, pastaj do ta frenojë edhe tërheqjen nga populizmi.

Zgjedhjet në Evropë këtë vit do të jenë të parat prej se është finalizuar dalja e Mbretërisë së Bashkuar nga Bashkimi Evropian në vitin 2020. Ato do të jenë të parat edhe pas disa krizave të rëndësishme të cilat kanë ndikuar rrënjësisht politikën në BE dhe në vendet e saj anëtare, të tilla si: pandemia Covid-19, pushtimi në shkallë të plotë i Ukrainës nga Rusia dhe lufta në Gazë.

Pjesëmarrja, si rëndom, pritet të jetë më e ulët se në zgjedhjet parlamentare kombëtare. Por, me fjalët e kryeministres italiane Giorgia Meloni - partia e së cilës ka rrënjë neo-fashiste - “koha e patriotëve ka ardhur”.

Deri më 12 qershor nuk do të ketë seanca të Kuvendit

Prishtinë, 27 maj - Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës,

udhëhequr nga kryetari Glauk Konjufca. Në mbledhjen e përbashkët me kryetarë të grupeve

parlamentare, kryetari Konjufca ka bërë me dije se për shkak të renovimeve në sallën e seancave plenare, që lidhen me

aparaturën e re, Kuvendi nuk do të mbajë seancë gjatë kësaj jave dhe as gjatë javës së ardhshme. Kryesia ndërkaq u pajtua që

Kuvendi të mbledhet në seancë solemne më 12 qershor 2024, në shënim të 25-vjetorit të çlirimit të Kosovës.

Mirëpritet opinioni ligjor i KiE-së rreth projektligjit për KPM-në



PRISHTINË, 27 MAJ - Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim i Evropës (OSBE) në Kosovë dhe Zyra e Bashkimit Evropian e kanë mirëpritur të hënën opinionin ligjor të përgatitur prej Këshillit të Evropës (KiE) rreth Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Medieve (KPM).

I ashtuquajtur i Projektligj për Komisionin e Pavarur të Medieve është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 27 dhjetor të vitit të kaluar dhe është dërguar për miratim në Kuvendin e Kosovës, ku është miratuar në lexim të parë.

Ky projektligj, mes të tjerash, parasheh licencimin e mediave online, monitorimin e tyre dhe gjoba deri në 40 mijë euro. Radio Evropa e Lirë ka fituar qasje në opinionin e KiE-së dhe në të ka parë një mori rekomandimesh.

Rekomandimet kryesore në opinionin e KiE-së

Në opinionin e Këshillit të Evropës është thënë se, në përgjithësi, projektligji harmonizohet me Direktivën për Shërbimet Mediale Audiovizuale, por disa prej

rekomandimeve për të janë: 1. Të qartësohet qëllimi i ligjit - të thuhet qartë se qëllimi i ligjit është të rregullojë sektorin e mediave audiovizive dhe të shtjellojë të drejtat dhe përgjegjësitë e shërbimeve të mediave audiovizive dhe shërbimeve të platformës së ndarjes së videove; 2. Të përcaktohen detyrimet e shërbimeve mediatike - përfshirë ato për t'i mbrojtur të miturit dhe për të ofruar materiale të qasshme për personat me aftësi të kufizuara; 3. Të largohen përkufizimet e panevojshme - të eliminohet përkufizimi i "shërbimeve mediatike audiovizive në internet (online)"; 4. Të qartësohen kërkesat për licencim dhe regjistrim - në përputhje me standardet evropiane; 5. Të vendosen sanksione dhe gjoba proporcionale - të sigurohet që sanksionet dhe gjobat të jenë proporcionale me ashpërsinë e shkeljeve, duke përcaktuar qartë llojet e shkeljeve dhe dënimet përkatëse; 6. Të qartësohen kompetencat dhe pushteti i Autoritetit Rregullator Kombëtar (ARRK) dhe të forcohet pavarësia e tij; 7. Të rritet transparenca së pronësisë së

medias; 8. Të krijohet një fondi për mbështetjen e medias; 9. Të promovohet vetërregullimi dhe bashkërregullimi; 10. Të adresohet dezinformimi dhe promovimi i edukimit medial.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës (KMSHK) i patën bërë thirrje Qeverisë së Kosovës të heqë dorë menjëherë prej ndryshimeve në projektligj, pasi diçka e tillë ishte konsideruar "sulm mbi mediat".

Misioni i OSBE-së dhe i BE-së kanë thënë se mbështesin qëllimin e projektligjit për ta harmonizuar legjislacionin e Kosovës me dispozitat përkatëse të BE-së, duke përfshirë Direktivën e shërbimeve audiovizuale por, "siç thekson raporti i Këshillit të Evropës, nevojitet më shumë punë në draft për të siguruar që ai mos ta nënvlerësojë pavarësinë e KPM-së dhe as të mos krijojë mospërputhje ligjore".

Dy trupat i kanë bërë thirrje Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale, Media dhe Zhvillim Rajonal të Kuvendit, të japë hapësirë për shqyrtimin e duhur të raportit dhe konsultimin

me palët e interesit të sektorit të medias, në mënyrë që rekomandimet e tij më pas të pasqyrohen në një draft të ri.

Zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, i pati thënë Radios Evropa e Lirë se ligji i ri buron prej direktivës së BE-së. "Ai parasheh rregulla të njëjta të veprimit për shërbimet mediale audiovizuale të cilave u nënshtrohen edhe televizionet private dhe publike".

Aktualisht, tekstet e publikuara në mediet online monitorohen nga Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës. Ai nuk gjobit mediet për gabimet e tyre, por merr vendime për ankesat e bëra ndaj mediave dhe më pas vendimet e Këshillit mund të përdoren për të ngritur padi civile ndaj mediave nëpër gjykatat e Kosovës.

Komisioni i Pavarur i Medieve (KPM) - i themeluar në vitin 2005 - është organ kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit në Republikën e Kosovës.

AGK-ja funksionon si shoqatë joprovitabile, ndërsa KMSHK-ja është trup vetërregullues.

Diskutimi në Komisionin për Media të Kuvendit të Kosovës

Deputetët e Komisionit për Media të Kuvendit të Kosovës janë zotuar të hënën se do ta marrin parasysh edhe opinionin e Këshillit të Evropës. "Opinionin ligjor e ndihmon Komisionin që çështjet që do të kalojnë do ta kenë edhe një filtër nga Këshilli i Evropës", ka thënë Valon Ramadani nga partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje.

Deputeti Mërgim Lushtaku i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) ka thënë se Komisioni duhet të ketë kujdes "te pjesa që kemi ngritur shqetësimet tona, te ndalimi i partive politike që të themelojnë televizione. Besoj se kjo e vret median e lirë".

Kosova ka shënuar regres sa i përket lirisë së mediave, sipas organizatës joqeveritare Reporterët pa Kufij. Në Indeksin e saj Botëror të Lirisë së Shtypit për vitin 2024, Kosova renditet e 75-ta nga 180 shtete, apo 19 vende më poshtë sesa në vitin paraprak, kur mori vlerësimin më të mirë në një dekadë e gjysmë.

Fillon "Java e Bibliotekës në Kosovë" me temën "Transformimi i bibliotekave në vend"

PRISHTINË, 27 MAJ - Në ceremoninë hapëse, e cila është mbajtur në hollin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", është bërë edhe përrurimi i Qendrës së Digjitalizimit, përrurimi i projektit "Krijimi i qasjes për persona me aftësi të kufizuara", si dhe është hapur ekspozita "Kujtesa për Skënderbeun" e koleksionueses së librave antikuare, britanikes Patricia Nugee.

Në këtë ngjarje të rëndësishme për bibliotekat

fjalë mbajtën kryeministri Albin Kurti, ushtruesja e detyrës e drejtorit të Bibliotekës Kombëtare, Bukurie Haliti dhe anëtarja e Këshillit Drejtues së Bibliotekës Kombëtare, Blerta Ismaili.

Kryeministri Kurti theksoi se mbi gjysmë milioni euro janë dedikuar për digjitalizimin e shërbimeve të Bibliotekës Kombëtare, duke bërë me dije se deri më tani janë digjitalizuar rreth 600 mijë objekte digjitale, përfshirë gazetën "Rilindja" dhe

koleksionet e rralla dhe të vjetra.

Të pranishëm në këtë ngjarje ishin edhe ministri Hajrulla Çeku, koleksionistja e njohur britanike Patricia Nugee, ambasadori i Shqipërisë, Petrit Malaj, anëtarë të KD-së të Bibliotekës Kombëtare, profesori nga Departamenti i Antropologjisë në Fakultetin Filozofik, Arsim Sinani, nga CHwB Kosova, Alban Morina, përfaqësues të kulturës, profesorë, artdashës dhe adhurues të librit.



KDI-ja dhe komuna e Gjakovës nënshkruajnë paktin e parë të integritetit në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 MAJ - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) - degë e Transparency International në Kosovë dhe komuna e Gjakovës, në kuadër të aktivitetit të USAID-it për Integritet të Komunave të Kosovës, kanë nënshkruar Paktin e parë të Integritetit në Kosovë, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt transparencës dhe përgjegjshmërisë sa i përket prokurimit publik në qeverisjen lokale.

Ky pakt, i cili synon t'i forcojë praktikën e mira qeverisëse dhe ta luftojë korrupsionin në prokurimin publik, është një marrëveshje e rëndësishme që vendos standarde të reja për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile. Nënshkrimi i këtij pakti tregon përkushtimin e të dyja palëve për të promovuar një administratë të



hapur dhe të ndershme, që shërben në të mirë qytetarëve të Gjakovës.

Në ceremoninë e nënshkrimit, kryetari i komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, theksoi rëndësinë e këtij pakti për të garantuar një

qeverisje të drejtë dhe transparente. "Ky pakt, i mbështetur nga aktiviteti i USAID-it për Integritet të Komunave të Kosovës, do të na ndihmojë ta përmirësojmë performancën tonë administrative dhe ta rrisim

besimin e qytetarëve në institucionet tona", tha Gjini. Në anën tjetër, drejtori ekzekutiv i KDI-së, Ismet Kryeziu, u shpreh se ky është një hap thelbësor drejt krijimit të një kulture të re të integritetit në sektorin publik. "Ne

besojmë se ky pakt do të shërbejë si model për komunat e tjera në Kosovë dhe do të nxisë praktika të mira qeverisëse në mbarë vendin", tha Kryeziu.

Pakti i Integritetit përfshin një sërë masash konkrete, përfshirë transparencën në proceset e prokurimit publik, pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje si dhe zbatimin e mekanizmave të fortë të kontrollit dhe balancës.

KDI-ja do të luajë një rol kyç në monitorimin e zbatimit të këtij pakti, duke siguruar që të gjitha masat të përmbushen sipas planit.

KDI-ja dhe komuna e Gjakovës ftojnë qytetarët dhe mediet që ta ndjekin nga afër zbatimin e këtij pakti dhe të kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të qeverisjes lokale. Kjo marrëveshje është vetëm fillimi i një përkushtimi të ri për një administratë publike më të hapur dhe më të përgjegjshme.

Ambasadori i BE-së: Kosova ta heqë ndalimin e mallrave serbe sa më shpejt

PRISHTINË, 27 MAJ - Ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ka folur të hënën në Forumin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të organizuar nga Këshilli Evropian i Investitorëve. Forumi mbledhi së bashku liderë nga biznesi, politika dhe financat për të diskutuar për strategjitë për arritjen e ndryshimeve transformuese drejt një të ardhmeje më të gjelbër.

Ambasadori Szunyog shtjelloi planin e ri të rritjes për Ballkanin Perëndimor dhe rëndësinë e bashkëpunimit rajonal. "Plani i ri i Rritjes për Ballkanin Perëndimor do t'i sjellë partnerët tanë, përfshirë Kosovën, më afër tregut të përbashkët të BE-së, do ta nxisë rritjen ekonomike dhe do ta përshpejtojë konvergencën socio-ekonomike", tha ambasadori Szunyog.

Ai theksoi se Kosova dhe partnerët e tjerë të Ballkanit Perëndimor mund të përfitojnë shumë nga ky plan, me kusht që t'i zbatojnë reformat e kërkuara. Ndërsa theksoi se qasja në tregun e vetëm të BE-së kalon përmes Tregut të Përbashkët



Rajonal, ambasadori Szunyog bëri thirrje për heqjen e pengesave aktuale. "Nëntë

iniciativa të përgatitura plotësisht në nivel teknik janë të bllokuara në Komitetin e

Përbashkët të CEFTA-s. Përzgjedhja e drejtorit të ri të CEFTA-s, e cila filloi mbi një vit

më parë, po ecën shumë ngadalë. Përzgjedhja e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal ka ngecur për vite me radhë - procedura në vazhdim duhet të japë një rezultat të qartë. Të gjitha palët duhet të punojnë në mënyrë konstruktive dhe pragmatike për të arritur rezultate të dobishme reciproke", tha ai.

Ambasadori, gjithashtu, vuri në dukje se që integrimi ekonomik rajonal të ketë sukses, Kosova duhet të punojë ngushtë me fqinjët e saj. "Në këtë drejtim, lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve dhe punëtorëve është një komponent kyç i Planit të Rritjes. Prandaj, inkurajoj Kosovën ta heqë ndalimin e mallrave serbe sa më shpejt të jetë e mundur", përfundoi ambasadori Szunyog.


Instrumenti i Reformës dhe Rritjes për Ballkanin Perëndimor është shtylla financiare e Planit të Rritjes. Duke mbuluar periudhën nga 2024 deri më 2027, pritet të ofrojë deri në 2 miliardë euro grante dhe 4 miliardë euro kredi për gjashtë partnerët e BE-së në Ballkanin Perëndimor në vitet e ardhshme.

Vazhdon modernizimi i infrastrukturës arkivore në Kosovë

Prishtinë, 27 maj - Në fillim të këtij viti ka filluar digjitalizimi masiv i materialit arkivor dhe deri më tani mijëra dokumente arkivore janë digjitalizuar, kurse tashmë është nënshkruar kontrata për rinovimin e ndërtesës së Agjencisë Shtetërore të

Arkivave të Kosovës, ka njoftuar Ministria e Kulturës. Aty parashihet rinovimi në hapësirat administrative, sallat e hulumtimit dhe të rregullimit të materialit arkivor, biblioteka, laboratorit i konservimit dhe restaurimit, laboratorit i digjitalizimit dhe

mikrofilmimit si dhe do të ketë ndërhyrje në hapësirat e jashtme. Zgjidhja e përhershme e problemit me hapësirat e nevojshme për lëndët arkivore po vazhdon edhe në Prizren, Gjilan, Mitrovicë dhe Gjakovë.



IFC-ja emëron Ines Rocha drejtoreshë të re rajonale për Evropën

PRISHTINË, 27 MAJ - IFC-ja ka emëruar Ines Rocha në pozicionin e drejtoreshës rajonale për Evropën. Rocha do të punojë nga zyra e Vjenës dhe do të ketë një rol kyç në tërheqjen e investimeve të sektorit privat dhe krijimin e vendeve të reja të punës në Evropën Qendrore dhe Lindore, me fokus në zhvillimin ekonomik të gjelbër, teknologjinë digjitale dhe përfshirjen financiare, si dhe drejtimin e programeve të IFC-së në përgjigje të pushtimit të Ukrainës nga Rusia.

Ajo do t'i drejtojë përpjekjet e IFC-së për zhvillimin e biznesit në Evropën Perëndimore për ta mobilizuar kapitalin dhe njohuritë në nxitje të rritjes së qëndrueshme ekonomike në tregjet në zhvillim.

Rocha, një shtetase portugeze dhe britanike, ka mbi 20 vjet përvojë në fushën financiare për zhvillimin ekonomik, së fundmi në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), ku ajo mbulonte bankat e Bashkimit Evropian dhe

strukturimet financiare në mbështetje të bizneseve të vogla në të gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore.

Kohët e fundit Rocha, si drejtuese e Departamentit të Ndikimit dhe Partneritetit në BERZH ndaj krizës në Ukrainë, ndihmoi në mobilizimin e një shume rekord nga aksionarët kryesorë dhe donatorë në ndihmë të ekonomisë dhe sektorit privat të Ukrainës. Në këtë rol ajo bashkëpunoi ngushtë me institucionet financiare zhvillimore dhe bankat shumëpalëshe të zhvillimit, duke përfshirë Bankën Botërore, Agjencinë Shumëpalëshe të Garancisë së Investimeve (MIGA) dhe IFC. Më parë ajo ka punuar në Bankën e Investimeve UBS Bank dhe Bankën Qendrore të Portugalisë. “Përvoja e madhe e Rochas e bën atë shumë të përshtatshme për këtë rol, veçanërisht tani kur ne ende vazhdojmë të punojmë në kushtet e ndikimit të pushtimit rus të Ukrainës”, tha Alfonso Garcia Mora, zëvendëspresident i IFC-së



për Evropën, Amerikën Latine dhe Karaibeve. “Jam i bindur se ajo do

të jetë në gjendje t'i orientojë programet e IFC-së në nivele edhe

më të larta, duke ndihmuar në përshejtimin e zhvillimit ekonomik të gjelbër, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, si dhe duke mobilizuar më shumë investime nga Evropa Perëndimore drejt tregjeve në zhvillim”, tha ai.

Në rolin e saj si drejtoreshë rajonale, Rocha do të fokusohet në drejtimin e ekipeve rajonale të IFC-së në zyrat e vendeve të Evropës Perëndimore, Qendrore dhe Lindore, si dhe në menaxhimin e marrëdhënieve me klientët, qeveritë dhe palët e interesuara. Ajo do të punojë dhe drejtojë zbatimin e strategjisë së IFC-së në rajon, duke punuar ngushtë me Bankën Botërore dhe MIGA-n, do ta udhëheqë zhvillimin e biznesit dhe do t'i mbikëqyrë operacionet e IFC-së në të gjithë sektorët. Rocha ka përfunduar studimet pasuniversitare në London School of Economics.

IFC-ja, anëtare e Grupit të Bankës Botërore, është institucioni më i madh në botë për zhvillim me fokus në sektorin privat në tregjet në zhvillim.

UNDP-ja lanson programin e ri për t'i ndihmuar bizneset mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë

PRISHTINË, 27 MAJ - Zyra e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë ka lansuar një program të ri për ta rritur qëndrueshmërinë ekonomike të bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë.

Programi u lansua në prani të zyrtarëve të lartë të autoriteteve qendrore dhe lokale, ambasadorëve, përfaqësuesve të donatorëve dhe kompanive që operojnë në Kosovë.

Gjatë aktivitetit u prezantuan mjetet e zhvillimit të biznesit të Programit të Rezistencës Ekonomike (ERP) që përbëhet nga tri metodologji. “1. Programi In Motion, është një mjet mbështetës i biznesit, objektivi



kryesor i të cilit është të përditësojë modelet e biznesit për bizneset mikro dhe të vogla duke ofruar asistencë

gjithëpërfshirëse të biznesit për të përmirësuar kapacitetin e tyre prodhues dhe marrëdhëniet me tregun. 2. Rriteni biznesin tuaj

(GYB) është një mjet mbështetës i biznesit, objektivi kryesor i të cilit është përmirësimi i kushteve financiare, administrative dhe produktive të bizneseve të vogla dhe të mesme, duke i përmirësuar ato për të pasur kapacitete për të krijuar marrëdhënie afatgjata të furnizimit, duke siguruar kështu qëndrueshmërinë, zgjerimin e tregut dhe përfitimin e tyre. 3. Programi i Zhvillimit të Furnizuesve (SDP) është një mjet mbështetës i biznesit që transformon marrëdhëniet e biznesit në zinxhirin prodhues midis një kompanie udhëheqëse (e madhe ose e mesme) dhe furnitorëve të saj (ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme)”,

është theksuar në lansimin e këtij programi.

Këto mjete janë dëshmuar tashmë shumë të suksesshme në disa vende ku UNDP-ja punon dhe një nga tregimet e biznesit në rritje u prezantua nga Qendra Rajonale e Panamasë e UNDP-së. Deri më tani më shumë se 40 000 kompani, nga të cilat 65 % drejtohen nga gratë, janë asistuar dhe kanë përmirësuar bizneset e tyre në 17 vende, më së fundi në Shqipëri, Kolumbi, Guajana dhe Paraguai.

Programi pritet t'i riprodhojë sukseset e arritura deri më tani duke sjellë mundësi për bizneset mikro dhe të vogla në Kosovë të rriten dhe të konkurrojnë në tregun më të gjerë.

Dhoma e Tregtisë kërkon nga qeveria t'i dëgjojë më shumë kërkesat e bizneseve

PRISHTINË, 27 MAJ - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë (DHTIK) ka shprehur shqetësimin lidhur me mosveprimin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në lidhje me Terminalin Doganor “Fitorja” në Ferizaj për vazhdim të licencës.

Terminalit Doganor në Ferizaj i skadon licenca e operimit më 24 qershor të këtij viti dhe ndonëse kompania ka bërë kërkesë për ri-licencim sipas afateve ligjore, ende nuk ka

asnjë përgjigje nga ministria në fjalë. “Lidhur me këtë çështje, mbi treqind (300) biznese dhe mbi njëzet (20) kompani të agentëve doganorë në Ferizaj kanë bërë peticione duke kërkuar vazhdimin e licencës të këtij Terminali Doganor. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë (DHTIK) kërkon nga Qeveria/Ministria e Infrastrukturës të ofrojë zgjidhje për këtë çështje duke i dëgjuar kërkesat e bizneseve dhe agentëve doganorë dhe t'ia vazhdojë

licencën e operimit Terminalit Doganor në Ferizaj, pasi mendojmë se kjo çështje ka të bëjë edhe me sigurinë e mallrave”, thuhet në reagimin e DHTIK-së.

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë shpreh shqetësimin se mbyllja eventuale e Terminalit në Ferizaj nuk do t'u shërbejë bizneseve dhe se nga kjo situatë do të përfitojnë kompanitë transportuese nga shtetet e tjera të cilat përbëjnë rreth 90 % të transportit rrugor.



Ja se si Mao Ce Dun e ndryshoi mbi 100 vite më parë fatin e Kinës bashkëkohore



Kongresi i parë kombëtar i Partisë Komuniste të Kinës nisi më 23 korrik 1921 në Shanghai, por punimet vazhduan në bordin e një anijeje të ankoruar në një liqen në Jiaxing. Të 12 delegatët pjesëmarrës në atë aktivitet, hartuan statutin e parë të partisë, që propozonte kërkimin e një dëmtshpërblimi për një vend të shkatërruar nga luftërat, të varfëruar dhe në prag të kolapsit.

Një ndër objektivat kryesore që u miratuan ato ditë ishte përmbysja e borgjezisë dhe ndërtimi i një shoqërie socialiste përmes luftës së klasave, diktaturës së proletariatit dhe shtetëzimit të mjeteve të prodhimit. Në mesin e themeluesve ishte edhe një djalë i ri 27 vjeçar, që çerek shekullin që pasoi do ta kalonte Kinën nga Mesjeta në modernizëm. Ai quhej Mao Ce Dun.

Timonieri i Madh që vdiq urie popullin e tij

Rebel dhe statist, politikan me një zgjuarsisë djallëzore dhe një

strateg ushtarak i aftë, Mao ishte “Timonieri i Madh” i Revolucionit Komunist Kinez. Një figurë e madhe, që megjithatë, do të jetë e lidhur përgjithnjë me madhësinë e krimeve të tij, dhe me një periudhë të paparë terrori, në të cilën vdiqën dhjetëra miliona njerëz.

Mao lindi më 26 dhjetor 1893 në Shaoshan në provincën Hunan, në zemrën rurale të perandorisë kineze Cin. Në vitin 1911 -kur nuk kishte mbushur ende 17 vjeç – ai iu bashkua revoltës popullore që çoi në rënien e perandorisë.

Në vitin 1923, në kongresin e tretë të Partisë Komuniste të Kinës, ai u zgjodh anëtar i Komitetit Qendror. Në atë fazë, Mao nisi të shtjellonte shumë nga tezat e tij politike, duke identifikuar rebelimet e fshatarëve si burimin ku duhej të bazohej revolucioni.

Në vitin 1928, Kongresi i Partisë Komuniste të Kinës mbështeti ngritjen e sovjeve rurale sipas modelit rus, dhe i ngarkoi me zbatimin e reformës agrare. Por profili i tij si një udhëheqës i padiskutueshëm u shfaq në

vitet 1930, gjatë luftës civile.

Në vitin 1934 ai udhëhoqi të ashtuquajturin Marshimi i Gjatë, me një kosto shumë të lartë sa i përket jetëve të humbura, ushtria komuniste arriti të thyejë ushtrinë nacionaliste të Çang Kai-Shek.

Një revolucion falimentues

Revolucioni komunist pati sukses menjëherë pas fundit të Luftës së Dytë Botërore. Më 1 tetor 1949 në Sheshin Tiananmen të Pekinit, Mao shpalli lindjen e Republikës Popullore të Kinës, të cilën e drejtonte vetë. Nga ai moment, edhe falë angazhimit ekonomik dhe ushtarak të Moskës, Kina nisi rrugën drejt modernitetit, por duke u shtypur nga njëra prej diktaturave më të pamëshirshme të shekullit XX. Timonieri i Madh e shtetëzoi ekonominë për të nxitur zhvillimin e shpejtë të bujqësisë dhe industrisë, dhe nxiti reforma të ndryshme. Në vitin 1958, ai filloi të ashtuquajturin Hapi i Madh Përpara, një plan i

madh ekonomik dhe shoqëror, që synonte ta bënte Kinën një nga fuqitë kryesore industriale më të mëdha në botë.

Por në vend të kësaj, për shkak të urisë së madhe që goditi vendin duke nisur që nga viti 1959, rreth 30 milionë kinezë vdiqën nga uria. Ishte një dështim epokal, megjithatë Mao ia doli të vazhdonte të qëndronte në krye të vendit.

Revolucioni Kulturor: Kura që vret


Për të shmangur përgjegjësinë e tij nga pasojat e katastrofës ekonomike dhe sociale, dhe për t’iu kundërvënë aparatit të Partisë Komuniste që po përpiqej të reduktonte kompetencat e tij, Timonieri i Madh nisi të ashtuquajturin Revolucion Kulturor. Në atë kohë u sulmuan jo vetëm udhëheqësit, zyrtarët e partisë, por të gjithë ata që kishin shprehur kritika ndaj politikave të Maos. Dhjetëra mijëra qytetarë të zakonshëm u persekutuan, u burgosën, u torturuan dhe vranë.

Deri në vitin 1968 pati një përshkallëzim dramatik të dhunës. Studentët e rekrutuar tek Garda e Kuqe shënjestronin kryesisht mësuesit, të cilët u sulmuan, u poshtëruan dhe u rrahën në publik, u vranë ose u detyruan që të vrisnin veten.

Lufta për pushtet që pasoi

Mao vdiq më 9 shtator 1976. Për vite me radhë ai kishte vuajtur nga një sëmundje degenerative dhe nga probleme të shumta të shkaktuara nga pirja e duhanit. Pas një funerali solemni në Sheshin Tiananmen, ku morën pjesë mbi 1 milionë njerëz, trupi i tij i balsamuar u zhvendos në një mauzole të madhe të stilit sovjetik.

Vdekja e tij solli shpërthimin e një lufte të egër për pushtet midis zyrtarëve të ndryshëm të partisë, që deri në atë moment nuk ishin ndjerë. Në fund dominoi fraksioni i presidentit Ten Hsiao Pin, që ruajti parimin e autoritetit absolut të partisë kundër çdo lloj demokratizimi dhe pluralizmi. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Senad Jaroviq, 'Ylli i javës' në Superligë

GJILAN, 27 MAJ - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 36 në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të SC Gjilanit, Senad Jaroviq. Vlerësimi i më të mirit të javës

është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje: Synaj Keqi, Naim Kodraliu, Blerim Haxholli. Ky komision ka vendosur që çmimi "Ylli i Javës" për xhiron e 36 t'i jepet Senad Jaroviq, i cili shënoi dy gola dhe një asistim në fitoren

vendimtare të skuadrës së tij ndaj Dukagjinit (4:2) për t'iu shmangur barazhit. Pasi mori këtë çmim, Jaroviq u shpreh i lumtur që u vlerësua sërish si më i miri i javës dhe që skuadra e tij e arriti objektivin e këtij edicioni: "Jam i lumtur që ia arritëm objektivit për

t'i ikur barazhit. Falënderoj tërë ekipin, kryesinë dhe shtabin teknik në krye me Gentjan Mezanin. Kam kaluar një kohë fenomenale në Gjilan dhe dua t'i falënderoj tifozët të cilët më kanë pranuar me ngrohtësi. Për mua ishte nder të isha pjesë e Gjilanit".



Llapi 'blindon' Januzin, Musollin dhe Avdylin

Klubi që drejtohet nga Tahir Batatina ka "blinduar" tre futbollistë me përvojë të madhe: Ahmed Januzi, Besar Musolli dhe Ilir Avdyli. Në ditët e ardhshme pritet që kjo skuadër ta vazhdojë kontratën edhe me futbollistë të tjerë

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 MAJ - Skuadra e Llapit përfundoi kampionatin në vendin e dytë në Superligë dhe kjo pozitë e dërgon në garat e Ligës së Evropës. Llapjanët nuk kanë humbur shumë kohë dhe kanë filluar të mendojnë për të ardhmen dhe në këtë mënyrë kanë "blinduar" tre lojtarë me përvojë të madhe. Fjala është për sulmuesin Ahmed Januzi, mesfushorin Besar Musolli dhe portierin Ilir Avdyli. Llapi ka

njoftuar të hënën se vazhdimi i kontratës me ish-sulmuesin e Kombëtares së Shqipërisë, Ahmed Januzi, vjen pasi ka kontribuar shumë për skuadrën, për rezultatet e arritura dhe kualifikimin në Evropa Ligë. Edhe vetë Januzi ka qenë shumë i kënaqur me vazhdimin e bashkëpunimit. "Ndihem jashtëzakonisht i vlerësuar nga klubi pasi më ofroi kontratë të re, të cilën e pranova pa asnjë hezitim dhe jam shumë i kënaqur që do vazhdoj ta jap kontributin tim për ekipin e



Llapit. Këtu jemi si një familje dhe e mbështesim jashtëzakonisht shumë njëri-tjetrin, si stafi ashtu edhe futbollistët mes vete. Ndiej keqardhje që nuk e arritëm titullin kampion, por tifozëve të zjarrtë 'Ultras Legjendat' u premtojmë angazhim maksimal

për t'i gëzuar ata me suksese si në Evropë ashtu edhe në sezonin e ri të Superligës", ka deklaruar Januzi, i cili në 32 ndeshje ka kontribuar me 10 gola e 4 asistime. Derisa për vazhdimin e kontratës me Musollin, Llapi ka vlerësuar se lojtari në fjalë me përvojën i ka ofruar shumë kualitetet mesfushës, andaj klubi nuk ka pasur shumë mëdyshje për vazhdimin e bashkëpunimit. Musolli u ka premtuar tifozëve llapjanë angazhim dhe rezultate pozitive në Evropa Ligë si dhe në edicionin e ri në Superligë. "Normalisht që jam i kënaqur me vazhdimin e kontratës. Ishte sezoni im i parë pas shumë vitesh larg vendlindjes, por që mund të them se ishte mjaft i suksesshëm si për mua ashtu

edhe për ekipin. Jam pritur mirë dhe jam ambientuar shpejt. Tifozët nuk arritëm t'i shpërblenim me titullin kampionë për mbështetjen e tyre të zjarrtë, por u premtojmë angazhim maksimal për të korrur sa më shumë suksese në Evropa Ligë dhe sezonin vijues të Superligës", ka deklaruar Musolli.

Ndërsa rinovimi i kontratës me Ilir Avdylin është edhe për dy vite të tjera. Portieri me përvojë të madhe ka pasur sezon fantastik duke mbajtur plot gjashtëmbëdhjetë herë portën e pa prekur, duke ofruar siguri të jashtëzakonshme për ekipin në secilën ndeshje që është paraqitur, madje pritjet e tij kanë qenë shpeshherë vendimtare për rezultatet e ekipit llapjan.

Fillon Kursi për Licencën UEFA A, Ademi: Ditë të rëndësishme për futbollin e Kosovës

"Epoka e re"

PRISHTINË, 27 MAJ - Për herë të parë në historinë e futbollit të Kosovës, Federata e Futbollit e Kosovës ka nisur kursin për trajnerë për Licencën UEFA A. Pas një ecurie të suksesshme në kurset e Licencës C dhe B, FFK-ja është autorizuar nga UEFA për t'i mbajtur edhe kurset e Licencës A, gjë që dëshmon përparimin e jashtëzakonshëm të bërë nga Departamenti i Edukimit. Në këtë kurs janë përfshirë 20 trajnerë të përzgjedhur, të cilët gjatë gjashtë muajve të ardhshëm, përveç ndjekjes së ligjeratave, do ta kenë edhe

punën praktike dhe monitorimin në klube. Në përfundim të kursit, trajnerët do t'i nënshtrohen një provimi dhe ata që e kalojnë me sukses do të marrin Licencën UEFA A. Në hapjen e këtij kursi historik, në Kampin Nacional të FFK-së, në Hajvali, ishte i pranishëm edhe presidenti i FFK-së, Agim Ademi, i cili përshëndeti trajnerët pjesëmarrës dhe theksoi rëndësinë e madhe të këtij kursi. "Sot është një ditë shumë e rëndësishme për FFK-në dhe për futbollin e Kosovës. Pas kurseve bazike për Licencën C dhe B, tanimë kemi kaluar në nivelin profesional, ku për herë të parë organizojmë kursin për Licencën A. Ne kemi filluar



organizimin e kurseve për trajnerë në vitin 2018 dhe që nga ajo kohë kemi bërë hapa gjigantë në sektorin e edukimit. Në bazë të punës që kemi bërë mendoj se edhe më herët e kemi merituar të fillojmë kurset e Licencës A, por pandemia Covid-19 pati ndikimin e saj. Sidoqoftë, fakti që

në kurset e Licencave C dhe B nuk kemi pasur asnjë vërejtje nga UEFA dëshmon punën e mirë që kemi bërë. Ju jeni gjenerata e parë e trajnerëve që jeni të përfshirë në këtë kurs dhe do të mbeten në histori. Shpresoj se me punën tuaj do të arrini ta kryeni me sukses këtë kurs", ka thënë Ademi, i cili ka falënderuar UEFA-n për mundësinë e dhënë, si dhe Federatën Shqiptare të Futbollit për ndihmën e dhënë në edukimin e trajnerëve të Kosovës deri tani. Ai, gjithashtu, vlerësoi punën e shkëlqyer të Departamentit të Edukimit në FFK, duke theksuar se puna do të vazhdojë deri në marrjen e autorizimit për Licencën UEFA

Pro. Trajnerët pjesëmarrës u shprehën të lumtur që tashmë kanë mundësinë që kursin për Licencën A ta kryejnë në Kosovë, duke falënderuar FFK-në për këtë mundësi. Ata shpresojnë që shumë shpejt do ta kenë rastin ta ndjekin edhe kursin për Licencën UEFA Pro. Ligjërues në këtë kurs është instruktori i njohur Klaus Stark, i cili do t'i drejtojë trajnerët gjatë këtij rrugëtimi të rëndësishëm profesional. Ky kurs për Licencën UEFA A është një hap i madh përpara për futbollin e Kosovës dhe një dëshmi e përkushtimit të FFK-së për ta ngritur nivelin profesional të trajnerëve në vend.

Bologna e dëshiron 'Lewandowskin' e Kosovës

Bologna, 27 maj - Bologna ishin padyshim surpriza më e bukur e këtij sezoni në Serinë A, me "Kuqeblutë" që siguruan me meritë një biletë në grupet e Ligës së Kampionëve për sezonin e ardhshëm. Nga klubi,

përveç trajnerit Thiago Motta, pritet të largohet edhe Joshua Zirkzee, derisa drejtuesit e Bolognas kanë nisur punën për ta gjetur zëvendësuesin e tij dhe në listën e dëshirave është edhe një shqiptar. Bëhet fjalë

për Albion Rrahmanin, sulmuesin e Përfaqësueses së Kosovës, pjesë e Rapid Bucurestit në Rumani. Rrahmani ka realizuar plot 19 gola këtë sezon me ekipin kryeqytetas, teksa numëron

edhe pesë asistime dhe falë këtyre performancave pozitive ka tërhequr vëmendjen e klubeve të ndryshme. Për "Lewandowskin" e Kosovës të interesuara janë edhe Benfica dhe Werder Bremen.



Duka për organizimin e Evropianit me Serbinë: Kjo gjë i shërben edhe njohjes së Kosovës

TIRANË, 27 MAJ - Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, ka folur edhe për aplikimin e Shqipërisë për organizimin e Evropianit 2027 për U-21 së bashku me Serbinë, duke theksuar se diçka e tillë ka për

t'i shërbyer edhe Kosovës. "Organizimi i Evropianit U-21 është diçka e madhe dhe shanset për të fituar të vetëm këtë organizim, thënë të drejtën, ishin të vogla. Organizimi i Evropianit U-21 është me interes për vendin,

pasi e fusim Shqipërinë në hartën e vendeve që organizojnë më së miri. Vetëm futbollit të jep mesazhe paqeje dhe bashkëpunimi. Kjo gjë i shërben edhe njohjes së Kosovës", ka deklaruar Duka. Vendimi i Dukës ishte

kritikuar ashpër nga të gjitha anët ku ka shqiptarë duke e pasur parasysh të kaluarën e hidhur të shqiptarëve me serbët dhe për qasjen aktuale të serbëve ndaj shqiptarëve, mbi të gjitha ndaj atyre të Kosovës.



Spanja publikon listën e lojtarëve të grumbulluar për 'Euro 2024'

MADRID, 27 MAJ - Spanja është padyshim rivalja më e fortë e Kombëtares së Shqipërisë në Evropianin e Gjermanisë. "Iberikët" në krye me teknikun Luis de la Fuente kanë publikuar listën e lojtarëve të grumbulluar në kuadër të fazës finale të Kampionatit Evropian të Futbollit që do të zhvillohet nga 14 qershori deri më 14 korrik, "Euro 2024". "Numri 1" i bankinës ka lënë jashtë listës së Evropianit "fantazistët", Isco dhe Ansu Fati, ndërsa Pau Cubarsi, Vivian dhe Marc Cucurella janë grumbulluar për herë të parë në ndeshje zyrtare të Spanjës, pas miqësoreve të marsit, si dhe Ayoze Perez që grumbullohet për herë të parë nga "La Furia Roja" spanjolle, për një event të madh, siç është edhe Kampionati Evropian i futbollit. "Të gjithë lojtarët kanë mundësitë e njëjta që të ftohen në Euro 2024. Dua ta bëj këtë të qartë që në fillim. Lista e gjatë ishte për t'i zvogëluar rreziqet dhe për të mbuluar



ndonjë ngjarje të përzgjedhësi i Spanjës, Luis De la Fuente.

LISTA E PLOTË:

Portierët: Unai Simon, David Raya, Alex Remiro.

Mbrojtësit: Carvajal, Navas, Laporte, Le Normand, Nacho, Vivian, Cubarsi, Grimaldo, CuCurrella.

Mesfushorët: Rodri, Zubimendi, Fabian, Merino, Marcos Llorente, Pedri, Aleix Garcia, Alex Baena, Fermin Lopez.

Sulmuesit: Morata, Joselu, Oyarzabal, Dani Olmo, F. Torres, Williams, Yamal, Ayoze Perez.

Dallasi dhe Bostoni triumfojnë edhe në ndeshjet e treta

DALLAS, 27 MAJ - NBA ka dhuruar emocionet e radhës në dy ndeshjet e treta të serive finale në të dyja konferencat. Dallas Mavericks dhe Boston Celtics udhëheqin 3-0 serinë e ndeshjeve finale në konferencat përkatëse dhe janë një fitore larg finales së madhe për titullin kampion në NBA. Në Konferencën e Perëndimit, Dallasi fitoi me rezultat 116-107 ndaj Minnesotas. Pas dy fitoreve jashtë fushë, këtë herë ekipi teksan triumfoi para publikut të tij. Edwardsi realizoi 26 pikë për miqtë, por që nuk mjaftuan. Dyshja Luka Donçiq dhe Kyrie Irving bëri ligjin në fushë. Të dy yjet realizuan nga 33 pikë secili, një dyshe që duket se po çon ekipin e Dallasit drejt



historisë. Në Konferencën e Lindjes, ekipi i Bostonit fitoi me shifrat 114-111 në fushën e Indianas, në një sfidë të ekuilibruar deri në fund. Tatum me 36 pikë ishte vendimtar për Celticsin, duke

i bërë të pavlefshme 32 pikët e Nembhardit për Indianan. Nëse Dallasi dhe Bostoni fitojnë sfidat e radhës, të dy ekipet do të përballen për titullin kampion të NBA-s për këtë sezon.

SHKURT

Të mërkurën zhvillohet finalja e turnirit tradicional 'Demush Mavraj'

Finalja e turnirit tradicional "Demush Mavraj" në futboll të vogël do të zhvillohet të mërkurën nga ora 21:00. Ky turnir sivjet ka qenë shumë interesant, kurse në finale janë kualifikuar ekipi i "FC. Meriton Berisha" dhe ekipi i "Alfa I". Organizatorët kanë njoftuar se finalja do të zhvillohet në vendlindjen e dëshmorit të kombit dhe arsimitarit Demush Mavraj në Saradran. "Në vendlindjen e Arsimitarit... Me 29.05.2024 në ora 21:00. Ju presim në finalen e madhe e cila do të mbahet në fshatin Saradran. Sport, kulturë e organizim madhështorë ju pret. Ejani që së bashku ta kalojmë një mbrëmje madhështore", thuhet në njoftimin e organizatorëve të turnirit "Demush Mavraj".

Monaco në kërkim të Brojës

Sulmuesi Armando Broja mund të transferohet te Monaco, raporton e përditshmja franceze "L'Equipe". 22-vjeçari shqiptar e nisi këtë sezon me fanellën e Chelseat, por në janar u transferua te Fulhami, ku nuk la gjurmë. Gjithashtu nuk bën më pjesë në planet e Chelseat, që kërkon ta largojë. Monaco e përfundoi në vendin e dytë kampionatin në Ligën 1 këtë sezon, por ata po humbasin golashënuesin kryesor Wissam Ben Yedder. Sulmuesi kuqezi konsiderohet nga ata si zëvendësuesi ideal, i ri dhe me shumë energji, në një klub ku mund të shpërthejë. Armando Broja ka mjaft admires edhe në Premierligë, ku spikat West Ham, ndaj pritet të transferohet këtë verë. Kostoja e kartonit të tij mund ta kapë shifrën 20 milionë euro.

Gasperini, besnik i Atalantës

Pas fitores 3-0 ndaj Torinos në javën e fundit të Serisë A, trajneri i Atalantas, Gian Piero Gasperini, deklaroi se e ardhmja e tij është skuadra bergamaske. I pyetur nga mediet për të ardhmen, italianin u shpreh se është pjesë e Atalantës dhe do të vazhdojë të jetë edhe në të ardhmen. "Jam i lidhur me Atalantën dhe do të vazhdoj të jem edhe në të ardhmen. Asnjëherë nuk kam thënë ndryshe në këtë periudhë, nuk i kam lënë hapësirë asnjë diskutimi sepse kam qenë i fokusuar vetëm tek Atalanta. Këto ditë në Bergamo ka një eufori të jashtëzakonshme, festime të rëndësishme ende na presin dhe ne e kuptojmë se çfarë kemi bërë. Djemtë treguan se ende duan të garojnë dhe të marrin rezultate pozitive", ka thënë Gasperini.

Xavi: Do të ishte nder ta menaxhoja përsëri Barcelonën

Xavi Hernandez është larguar nga Barcelona dhe ndeshja e së dielës ndaj Valencias ishte e fundit për të në krye të gjigantit katalunas. Pasi ra dakord të vazhdojë ta drejtojë Barçën pas një vendimi të mëparshëm për t'u larguar, Barcelona vendosi ta shkarkojë Xavin javën e kaluar. Por Xavi beson se kapitulli i tij me klubin mund të rihapet në të ardhmen dhe ai shpreson që një gjë e tillë të ndodhë që të rikthehet një ditë në "Camp Nou". "Do të ishte një nder të menaxhoja përsëri një ditë klubin e jetës sime. Tifozët duhet të nxojnë se situata ekonomike është e vështirë. Po largohem me dashurinë e fansave dhe kjo më mbush me krenari", ka thënë Xavi. Thuhet se Xavi u kontaktua nga disa klube nëpër Evropë kur u konfirmua shkarkimi i tij. Megjithatë, mediet spanjolle raportojnë se ai planifikon të shkojë në një pushim njëvjeçar përpara se të kthehet në stërvitje.

Guardiola: Humbëm një finale, por ky sezon ka qenë i jashtëzakonshëm

Trajneri i Manchester City, Pep Guardiola, mori përsipër fajin për humbjen e finales së FA Cup. Skuadra e tij u mund 1-2 në finalen e "Wembley" nga Manchester Unitedi. "Së pari, urime për

Manchester Unitedin", ka thënë trajneri.

"Plani im i lojës nuk ishte i mirë. Pjesa e dytë ishte shumë më e mirë se e para, pasi ishim më intensivë. Lojtarët e dinë arsyen pse. Taktikisht

nuk ishte ndeshje e mirë. Ju planifikoni një lojë dhe pozicione të ndryshme, por nuk funksionoi", ka deklaruar Guardiola. "Si gjithmonë, kundër Unitedin ne kishim kontrollin, por nuk mundëm të

krijonim të tjera raste shënimi. Ndaj jemi të zhgënjyer që nuk fituam dot këtë trofe. Është normale kur një ekip humbet finalen, por ky sezon ka qenë i jashtëzakonshëm", u shpreh Guardiola. "Ne kemi luajtur për të

gjithë trofetë sezonalë në një mënyrë të mirë, por nuk fituam dot kudo si vjet. Tani duhet të pushojmë dhe të kthehemi më të fortë në sezonin e ardhshëm, pasi mund t'ia dalim mbanë", ka pohuar Guardiola.



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 8 par. 4, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L “Përparimi” Sh. A. në Vushtri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L “Përparimi” Sh. A., e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 835/24 të datës 27.05.2024 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L “Përparimi” Sh. A me datë 27.05.2024 shpall:

KONKURS PUBLIK

- I. Titulli:** Sigurim Fizik - roje
Numri i ekzekutuesve: 1
Orët e punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
Përgatitja profesionale: Shkolla e Mesme apo fillore
Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj
I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik
Lartësia e pagës mujore: 390.00Euro Bruto.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës;
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të organizatës, institucionit publik;
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent;
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik;
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë;
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit;
- Për punën që e kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;

Kushtet e veçanta

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Shkathtësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë;
- Preferohet të jetë i licencuar në fushën e sigurimit fizik;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L “Përparimi” Sh. A - Vushtri;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet)
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 28.05.2024 deri me datë 11.06.2024 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 19.06.2024.
- Afati për ankesë nga data 20.06.2024 deri me datë 24.06.2024.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 03.07.2024.
- Afati për ankesë nga data 04.07.2024 deri me datë 07.07.2024.

- Afati për ankesë nga data 15.07.2024 deri me datë 18.07.2024.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 20.07.2024.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L “Përparimi” Sh. A në qytetin e Vushtrisë, rr. “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga

ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

N.P.L “Përparimi” Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Print Screen” SH.P.K. me pronar Arsim Demiri, me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810170605 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Print Screen” D.O.O. Arsim Demiri, Gjilan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810170605 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Print Screen” L.L.C. Arsim Demiri with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 810170605 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Zainteresovani kandidati mogu preuzeti prijavni formular u Arhivskoj kancelariji J.P.L “Përparimi” A.D. u gradu Vuçitru, ul. “Dorda Kastrioti Skenderbega” br. 82, (bivši objekat TMK-a pored Osnovnog suda Mitrovica - odeljenje u Vuçitru) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Odeljenje za kadrove, primenjujući član 8, stav 3, Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Regulaciju Postupka Konkursa u Javnom Sektoru, pružiće potrebna objašnjenja kandidatima u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, i pomoći će im i dati potrebne upute za prijavu putem elektronske adrese.

Predaja prijave sa celokupnom traženom dokumentacijom u ovom javnom pozivu mora se obaviti samo putem elektronske adrese kako sledi: hrperparimi@gmail.com.

N.P.L “Përparimi” S.A. u Vuçitru nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo.

Sva komunikacija tokom postupka javnog konkursa odvijace se putem elektronske komunikacije.

Napomena: Prijave dostavljene nakon predviđenog roka neće biti prihvaćene.

- Rok za žalbe od datuma 04.07.2024. do datuma 07.07.2024.
- Period kada će kandidati biti podvrgnuti usmenom intervjuu i ocenjivanju najkasnije do datuma 12.07.2024.
- Rok za žalbe od datuma 15.07.2024 do datuma 18.07.2024.
- Objavljivanje konačnih rezultata u vezi sa uspešnim kandidatom najkasnije do 20.07.2024.

Narativni kalendar postupka regrutacije može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je podneta žalba ili ne, i u zavisnosti od rada ocenjivačke komisije i odeljenja za kadrove. U svim slučajevima kada se podnese žalba u bilo kojoj fazi postupka regrutacije, žalba će imati suspenzivni efekat dok se ista ne razmotri od strane Komisije za žalbe.

U skladu s članom 8, članom 10 stav 2.2 i članom 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljenom u Službenom listu Republike Kosovo dana 01.12.2010. godine, u vezi s članom 7 Uputstva Administrativnog broj 01/2024 o uređivanju postupaka konkursa u javnom sektoru koji je dio Zakona br. 03/L-212 o radu objavljenog u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, i članom 8 stav 4, članom 11, članom 21 stav 2.2 i članom 25 Pravilnika br. 55/21 o radnom odnosu NPL „Perparimi“ Sh. A Sh. A. u Vuçitru, usvojenog dana 21.12.2021. godine od strane Upravnog odbora NPL „Perparimi“ Sh. A“ Sh. A., i uzimajući u obzir odluku sa brojem protokola 835/24 od 27.05.2024, godine od Izvršnog direktora, N.P.L „Perparimi“ Sh. A. 27.05.2024 objavljuje:

JAVNI KONKURS

- I. Naziv: Fizičko osiguranje – čuvar
Broj izvršitelja: 1
Radno vrijeme: 40 sati sedmično
Trajanje imenovanja: Određeni period od jedne (1) godine, od kojih će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.
Stručna sprema: Srednja škola ili osnovna škola
Radno iskustvo: Poželjno šest (6) meseci
Izveštava: Rukovodilac Odsjeka za fizičko osiguranje
Visina mesečne bruto plate: 390.00€.

Opis poslova i odgovornosti:

- Da bude sposoban da obavlja poslove radnog mjesta u punom radnom vremenu i bez ograničenja;
- Brine o osiguranju objekta i imovine organizacije, javne institucije;
- U slučaju opasnosti odmah obavještava nadležne osobe;
- Po potrebi može biti dodijeljen na drugu lokaciju radi fizičkog osiguranja;
- Obavezan je koristiti sve predviđene zaštitne mjere na poslu;
- Da bude sposoban koristiti protivpožarnu opremu;
- Odgovoran je rukovodiocu Odsjeka za fizičko osiguranje za obavljani posao;
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

Posebni uslovi:

- Da bude državljanin Republike Kosovo;
- Fizička sposobnost, poželjno je da ima završene obuke iz oblasti sigurnosti;
- Poželjno je da ima licencu iz oblasti fizičkog osiguranja;

Uz prijavu treba dostaviti:

- Formular za prijavu N.P.L „Përparimi“ Sh. A - Vuçitru;
- Dokaz o stručnoj spremi (skenirano);
- Izvod iz matične knjige rođenih; (elektronski izdatnica na platformi e-Kosova će se prihvatiti)
- Potvrdu o nekažnjavanju izdatu od Stručnog vijeća Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnom krivičnom registru Republike Kosovo (elektronski izdatnica na platformi e-Kosova će se prihvatiti);
- Dokaze o radnom iskustvu (skenirani) (nije obavezno);
- Kopiju lične karte (skenirano);

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja istog. Objava je otvorena od datuma 28.05.2024. do datuma 11.06.2024. u 16:00 sati.

Približni kalendar postupka regrutacije:

- Preliminarna verifikacija prijava kandidata najkasnije do datuma 19.06.2024.
- Rok za žalbe od datuma 20.06.2024. do datuma 24.06.2024.
- Period kada će kandidati biti podvrgnuti pisanim testovima i ocenjivanju najkasnije do datuma 03.07.2024.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- | | |
|--|---|
| - Alajdin Shamli BI shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit 810600644 Prizren. | Florent Gashi nga Rogova KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Asllan Berisha” Rogovë KK Gjakovë. |
| Vlera Kastrati shpall te pavlefshme diplomën, dëftesat , certifikatën shmgi “ Remzi Ademaj “ Prizren. | Saranda Koci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Zekiria Rexha” Gjakovë. |
| - Ilmi Sadrija shpall të humbur Certifikatën Furrteri, Mbi Aftësimin Profesional të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të Republikës së Kosovës me nr. 653/2015. | - Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994. |
| - Serdar Morina shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren. | - Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohu-ni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867. |
| - Albrim Isakaj shpall te pavlefshme 4 dëftesat , certifikatën dhe diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren. | - Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. |
| - Armand Xhemaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K”11 Marsi” Prizren. | - Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783. |
| - Fatlind Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë. | - Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328. |
| - Driton Ahmetaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 të sh.m.l.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë. | |
| - Ardian Kryeziu nga Rogova KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Asllan Berisha” Rogovë KK Gjakovë. | |



Në bazë të dispozitave të nenit 21, nenit 25 të ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarrjet Publike, respektivisht neni 13 të ligjit 04/L-111 për ndryshim dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarrjet Publike, si dhe ligjit numër 06/L-021 neni 22 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Komisioni i Auditimit i Ndërmarrjes Publike KRM "Pastrimi" Sh.A. në Prishtinë me datë 23.05.2024, mori vendim që të rishpallë, konkursin me afat prej 30 ditë për Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm:

KONKURS

Pozita e punës: Zyrtar/e i Auditimit të Brendshëm - 1 ekzekutues

Vendi dhe lokacioni i Punës: Prishtinë,

Zyrtari i Auditimit të Brendshëm / Nën mbikëqyrje të Komitetit të Auditimit

Kohëzgjatja e Kontratës së punës tri (3) vjeçare

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- I raporton komisionit të auditimit dhe bordit të drejtorëve për politikat, programet dhe aktivitetet e zyrës.
- Të planifikojë, organizoj dhe mbikëqyrë punën e zyrës së Auditimit të Brendshëm, duke përfshirë planifikimin, hartimin dhe menaxhimin e programit për auditimit, organizimin dhe delegimin e punëve dhe përllogaritjen e resurseve të nevojshme.
- Përgatitja e planit të punës, zbatimi dhe monitorimi.
- Të monitorojë zbatimin e të gjitha rekomandimeve të Komisionit të Auditimit.
- Të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të kontrolleve të brendshme (duke përfshirë ato financiare), si dhe të raportoj te Komisioni i Auditimit.
- Të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga KRM "Pastrimi" Sh.A të gjitha ligjeve të aplikueshme në Kosovë.
- Të propozoj masa që duhet të ndërmerren nga kompania për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të veprimtarisë.
- Në bazë të planit të auditimit, përgatitë raportet e auditimit për shqyrtim nga Komision i Auditimit.
- Bashkëpunon me zyrtarët e ndërmarrjes në koordinim me Kryeshefin Ekzekutiv.
- Kryen edhe punë dhe detyra tjera te cilat i caktohen nga komisioni i auditimit.

Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike, kontabilitet. master në drejtimet ekonomike me theks në kontabilitet dhe auditim do te jetë përparësi
- Së paku 5 vite përvojë pune menaxhuese në auditim të brendshëm, 5 vite përvoja menaxhuese në auditim të brendshëm konsiderohet përparësi;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e auditimeve të dëshkohet me kontrata, vendime;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme me theks Ligji per NP dhe I ligjeve qe kane te bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave publike;
- Shkathhtësi ne komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathhtësi kompjuterike ne aplikacione të programeve (word, Excel, Power Point, Access);
- Të jetë i certifikuar në auditim të brendshëm në sektorin publik leshuar nga MEF ose nga ndonje institucion relevant vendor ose ndërkombëtar si: përparësi është SKAK, etj.

Paraqitja e kërkesave

- Kërkesat dorëzohen në zyrën nr. 8. të KRM “Pastrimi” SH.A, Rr. Tahir Zajmi”nr.5, Prishtinë dhe duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:
- CV, Përvoja e punës e dëshmuar me dokumente veçmas dëshmi për përvojën menaxhuese në auditim (dokumente origjinale ose te noterizuara),Vërtetim nga trusti pensional,Diplomat e shkollimit fakultetit (e noterizuar), Diploma nga universitetet e huaja duhet te jete e nostrifikuar nga Ministria e Arsimit (dëshmi e noterizuar), Çertifikata e Auditimit (e noterizuar), Çertifikata e lindjes jo me e vjetër se gjashtë muaj, Kopja e letërnjoftimit, dëshminë se nuk jeni nën hetime jo me e vjetër se gjashtë muaj (originali).
- Deklarata nën betim.
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato që arrijnë pas afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.
- Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.
- Konkursi është i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.
- Informata shtesë mund të sigurohen përmes telefonit nr.038/603-191.

Kryesuesi i Komitetit Auditimit
Valon Gogiqi



Prema odredbama člana 21. 03/L- 087 o javnim preduzećima, odnosno članu 13. zakona 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 13. 03/L- 087 o javnim preduzećima, kao i broj zakona 06/L-021 član 22 o internoj reviziji javnih finansija, Revizorski odbor javnog preduzeća KRM "Čišćenje" Š.A. U Prištini 23.05.2024. doneta je odluka o ponovnom preseku konkursa sa rokom od 30 dana za službenika interne revizije:

TAKMIČENJE

Radno mesto: Službenik interne revizije - 1 izvršitelj

Lokacija i lokacija: lokacija

Službenik interne revizije / Pod nadzorom Odbora za reviziju

Trajanje ugovora od tri (3) godine

Dužnosti i odgovornosti:

- Izveštaj Odboru za reviziju i Upravnom odboru o politikama, programima i aktivnostima Kancelarije.
- Planiranje, organizovanje i nadgledanje rada Kancelarije za unutrašnju reviziju, uključujući planiranje, projektovanje i upravljanje programom revizije, organizovanje i Delegacija radova i obračun potrebnih resursa.
- Priprema plana rada, implementacije i praćenja.
- Pratite primenu svih preporuka Odbora za reviziju.
- Proverite adekvatnost i redovan rad internih kontrola (uključujući i finansijske) i javite se Odboru za reviziju.
- Provera prikladnosti i redovnog rada sistema i procedura koje imaju za cilj da garantuju implementaciju od strane RM "Čišćenje" Š.A. svih važećih zakona na Kosovu.
- Predložite mere koje će preduzeće preduzeti kako bi se povećala efikasnost i efikasnost aktivnosti.
- Na osnovu plana revizije, pripremite revizorske izveštaje za razmatranje od strane Odbora za reviziju.
- Sarađuje sa zvaničnicima kompanije u koordinaciji sa glavnim izvršnim direktorom.
- On takođe obavlja druge poslove i zadatke koje mu je dodelio revizorski komitet.

Kvalifikacije, radno iskustvo i veštine:

- Univerzitetska diploma iz ekonomije, prava, javne administracije, javnih finansija, računovodstva. Master u ekonomskim pravcima sa akcentom na računovodstvo i reviziju biće prednost
- Najmanje 5 godina iskustva u upravljanju internom revizijom, 5 godina iskustva u upravljanju internom revizijom smatra se prioritetom.
- Znanje i iskustvo iz oblasti revizije dokazano je ugovorima, odlukama;
- Poznavanje važećih zakona i propisa sa akcentom na Zakon o UN i zakone koji se odnose na unutrašnju kontrolu i upravljanje javnim finansijama;
- Komunikacione veštine, planiranje rada i vođstvo tima;
- Računarske veštine u softverskim aplikacijama (word, Excel, Power Point, Access);
- Da bude sertifikovan u internoj reviziji u javnom sektoru, kvalifikovan od strane MEF-a ili bilo koje relevantne lokalne ili međunarodne institucije kao: prioritet je SKAK, itd.

Bitka kod

- Zahtevi se podnose kancelariji br. 8. KRM "Čišćenje" Š. A, Tahir Zajmi"br.5, Priština i sledeća dokumenta moraju biti priložena:
- CV, Radno iskustvo dokazano sa posebnim dokumentima dokaz za iskustvo menadžmenta u reviziji (originalna ili notarizovana dokumenta), Uverenje iz penzijskog fonda, Fakultetska diploma obrazovanja (notarizovano), Diploma sa stranih univerziteta mora biti obaveštena od strane Ministarstva prosvete (notarizovan dokaz), Uverenje o reviziji (notarizovano), Izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od šest meseci, Kopija ID-a, dokaz da niste pod istragom ne stariji od šest meseci (original).
- Deklarata nën betim.
- Nepovezana dokumenta i oni koji stignu posle isteka roka za takmičenje neće biti razmatrani.
- Biće kontaktirani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.
- Konkurs je otvoren 30 dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi.
- Dodatne informacije možete dati telefonom 038/603-191.

Predsednik Odbora za reviziju
Valon Gogići





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

